

## 8. Përdorimi i ambienteve publike të bibliotekës

Karrocat për fëmijë, skuterët, këpucët me rrota dhe mjete të tjera për lëvizje duhet të lihen në paradhomën e bibliotekës. Kjo shërben për të garantuar sigurinë brenda ambienteve të bibliotekës, por edhe parandalon ndotjen. Ngrënia dhe pirja lejohet në tavolinat në Kaffi Egge. Gjithashtu edhe në tavolinat në pjesën e të rinjve në katin e 1-rë.

Nuk lejohet konsumimi i pijeve të ëmbla, ushqimeve me yndyrë (p.sh. patate të skuqura, çokollatë) dhe as ushqimet e çastit (fastfood).

Kafshët nuk lejohet të sillen në ambientet e bibliotekës. Përrjashtim nga rregullat e përcaktuara mund të bëhet pas konsultimit me menaxhmentin e bibliotekës.

## 9. Përrjashtimi nga përrdorimi

Personat, borxhi i të cilëve ndaj bibliotekës tejkalon shumën maksimale të specifikuar, nuk do të mund të huazojnë artikuj derisa ta shlyejnë borxhin. Zbatohen shumatat maksimale të mëposhtme:

Fëmijët deri në 16 vjeç	5 CHF
Të rinjtë e moshës 16 deri 20 vjeç	10 CHF
Të rriturit	20 CHF

Kushdo që shkel në mënyrë të përrsëritur rregulloren e bibliotekës mund të përrjashtohet përrkohësisht ose plotësisht nga përrdorimi i bibliotekës.

## 10. Përrjashtimi i përrgjegjësisë

Biblioteka nuk mban përrgjegjësi përr dëmet e shkaktuara nga përrdorimi i një mediumi të huazuar në një aparat, konzolë lojrash ose kompjuter në pronësi të përrdoruesit.

## 11. Pranimi

Përrmes regjistrimit përrdoruesit pranojnë rregulloren e bibliotekës.

## 12. Biblioteka e hapur (open library)

Përrdorimi rregullohet me rregulle të veçantë. Kontrata duhet të nënshkruhet gjatë marrjes së distinktit të bibliotekës së hapur.

## 13. Biblioteka e sendeve

Objektet mund të huazohen me një abonim të vlefshëm përr të rriturit. Përr sende të caktuara duhet të paguhet një depozitë (50 CHF) në para të gatshme. Malli duhet të kthehet i plotë, duke përrfshirë paketimin, dhe i pastër. Mallrat e dëmtuara ose kompletet që nuk kthehen të plota duhet të zëvendësohen.

## 14. Dispozita përrfundimtare

Kjo rregulle e bibliotekës hyn në fuqi më 1 Prill 2023 dhe zëvendëson të gjitha rregullet e mëparshme.

FVM



**BIBLIOTEKA**

Adresa: Brühlweg 3, 4132 MuttENZ


Telefoni: 061 462 01 90

Email: [bibliothek@frauenverein-muttENZ.ch](mailto:bibliothek@frauenverein-muttENZ.ch)

Shoqata mbështetëse: Shoqata e Grave MuttENZ

[www.frauenverein-muttENZ.ch](http://www.frauenverein-muttENZ.ch)

## Rregulle e bibliotekës



### Orari i hapjes:

E hënë	ora	14.00 – 18.00
E martë	ora	10.00 – 14.00
E mërkurë	ora	14.00 – 19.00
E enjte	ora	12.00 – 18.00
E premte	ora	14.00 – 18.00
E shtunë	ora	10.00 – 12.00

### Gjatë pushimeve shkollore:

ora	14.00 – 18.00
ora	14.00 – 19.00

Orare të tjera të veçanta të hapjes publikohen në bibliotekë dhe në faqen e internetit të Shoqatës së Grave MuttENZ.

## 1. Lejueshmëria

Biblioteka Muttenz është e hapur për përdorim për persona fizikë dhe institucione (p.sh. qendra ditore, klasa shkollore, me një person përgjegjës).

## 2. Kartela e bibliotekës

Personave të sapo regjistruar do t'u jepet një kartelë e bibliotekës. Kartela e humb vlefshmërinë e saj nëse nuk kryhet asnjë huazim gjatë një viti. Gjatë regjistrimit duhet të paraqitni një dokument identifikues zyrtar.

Kartela e bibliotekës është personale. Përdoruesit janë përgjegjës për huazimet e bëra me të dhe për borxhet e shkaktuara.

Ndryshimet e adresës dhe humbja e kartelës së bibliotekës duhet të raportohen menjëherë në Bibliotekën Muttenz.

## 3. Afatet e huazimit / Zgjatja e afatit

Mediat mund të huazohen vetëm nga personat e regjistruar me një kartelë të vlefshme biblioteke.

Afati i huazimit është zakonisht katër javë. Afati për huazimin e mediave të parazervuara mund të zgjatet një herë. Për DVD, revista, tonies, lojëra dhe objekte nga Biblioteka e Sendeve afati i huazimit është dy javë. Ky afat nuk mund të zgjatet.

Mund të huazoni një numër të pakufizuar për një lloj të medias dhe për grup moshë. Një kufizim zbatohet për produktet e reja të etiketuara (maksimumi 5 copë] dhe lojërat (maksimumi 1 lojë).

Përdorimi i e-kbl përfshihet në çmimin e abonimit. Regjistrimi/përdorimi i e-kbl nuk është i mundur me një abonim për fëmijë.

Mediat e huazuara mund të rezervohen (1 CHF për medium). Përdoruesi do të informohet për një rezervim të disponueshëm me email dhe mediumi duhet të merret brenda pesë ditëve. Për rezervimet që nuk merren ose anulohen nuk shuhet detyrimi për pagesë.

Fëmijët dhe të rinjtë mund të huazojnë media vetëm për grup moshën e tyre.

## 4. Kthimi i mediave

Mediat mund të dorëzohen në recepsion gjatë orarit të hapjes së bibliotekës. Biblioteka nuk merr asnjë përgjegjësi për mediat e deponuara në kutinë postare të bibliotekës ose në vende të tjera.

## 5. Tarifat / Shërbimet me pagesë

Të rriturit (një person)	50 CHF	në vit
Të rriturit, që jetojnë në të njëjtën familje	10 CHF	në vit
Të rinjtë e moshës 16 deri në 20 vjeç	10 CHF	në vit
Fëmijët deri në 16 vjeç, që jetojnë në Muttenz	0 CHF	
Fëmijët deri në 16 vjeç, që jetojnë jashtë Muttenz-it	10 CHF	në vit
Zëvendësimi i kartelës së bibliotekës	5 CHF	
Paralajmërimi i 1-rë	5 CHF	
Paralajmërimi i 2-të	10 CHF	
Paralajmërimi i 3-të	20 CHF	
Rezervimi	1 CHF	për titull
Porositja	1 CHF	për titull
Shpenzimet postare për rezervime / paralajmërimet	2 CHF	për një dërgesë postare
Zgjatja e afatit online në llogarinë e klientit	0 CHF	
Zgjatja e afatit me email	1 CHF	për një email
Abonimi i bibliotekës së hapur*	30 CHF	në vit

\* (i mundur me një abonim të paguar nga grup moshë mbi 18 vjeç)

Nëse blini një kartelë biblioteke, mund të huazoni media për një vit. Në rast mospërdorimi të kartelës, nuk keni të drejtë për rimbursim.

Personat që posedojnë një KulturLegi ose një Familienpass+ përfitojnë 50% zbritje në tarifën e abonimit.

## 6. Dëmtimi / Humbja

Mediat e huazuara duhet të trajtohen me kujdes. Në rast dëmtimi ose humbjeje, ju do t'i bartni shpenzimet për koston e riparimit ose zëvendësimit.

Edhe paketimi (p.sh. për DVD, CD dhe tonies) i dëmtuar duhet të zëvendësohet me pagesë. Për një paketim duhet të paguhet 5 CHF.

Mediat që nuk kthehen dy javë pas paralajmërimit të tretë do të konsiderohen të humbura dhe do të faturohen me vlerën e zëvendësimit.

## 7. Përgjegjësia

Ju lutemi kontrolloni mediat e huazuara. Dëmi duhet të raportohet brenda 24 orëve me telefon ose email.

Përgjegjësia për mediat e huazuara dhe respektimi i afateve të huazimit i takon përdoruesit.